

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit S. Sh. nga fshati Sh., Komuna e M., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë (MSH), për shkak të anulimit të vendimit administrativ nr..... të datës ....., duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.UZH.nr.120/2017 të datës 14.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02.11.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit S. Sh., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.120/2017 të datës 14.06.2017.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.120/2017 e datës 14.06.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit S. Sh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.555/2016 i datës 09.02.2017 është vërtetuar.

Paditësi, kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljeve të së drejtës materiale dhe rregullave procedurale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa, ndërsa aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe të kthehet në rivendosje, ose të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të goditur, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.120/2017 dt.14.06.2017 është refuzuar ankesa e paditësit S. Sh. paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.555/2016 dt.09.02.2017 me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit lidhur me anulimin e vendimit të të paditurës Ministria e Shëndetësisë(MSH) nr..... dt.....

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar që të anulohet vendimi i të paditurës. Qëndrimi juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimet e goditura nuk janë përfshirë me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendon paditësi në kërkesë.

Me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr.10/2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, parashihet se çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë të aplikojë në PJIP kur shërbimi i caktuar shëndetësor nuk ofrohet në institucionet publike shëndetësore, në pajtim me dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ. Neni 5 të këtij UA parashikon se në rastet emergjente kur në bazë të Raportit të Komisionit Konziliar dhe fletë-referimit nga institucioni publik shëndetësor, vlerësohet se është e rrezikuar jeta e qytetarit. Ministri i Shëndetësisë, ose në mungesë zvendësi i tij, mundëson fillimin ose në rastin e ditëve të pushimit zyrtar vazhdimin e trajtimit jashtë institucionit publik shëndetësor para përfundimit të procedurës administrative të paraparë me dispozitat e këtij UA, nepërmjet lëshimit sa më të shpejtë të fletë-garancionit për mbulimin e plotë ose të pjesërishtëm të shpenzimeve të trajtimit, nëse është e nevojshme edhe në mënyrë retroaktive por jo më larg se 72 orë nga fillimi i trajtimit. Tutje, në nenin 6 të UA parashikohet aplikimi i rasteve jo-emergjente kur procedura administrative përfundon me nënshkrimin e kërkesës për zotimin e mjeteve financiare nga menaxheri i programit buxhetor dhe zyrtari autorizues i Ministrisë. Ndërsa në nenin 7 parashikohen përgjegjësitë dhe të drejtat individuale të aplikuesit kur refuzohet kërkesa e pacjentit për kompenzim, sipas nenit 4 dhe nenit 6 të këtij Udhëzimi, nëse pacienti ka filluar trajtimin mjekësor pa përfunduar procedurat e rregullta administrative sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

Duke i pasur parasysh dispozitat e lartë theksuara, kjo Gjykatë gjeti se organi administrativ dhe gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë vepruar kur kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit. Bazuar në të lartëcekurat, kërkesa për trajtim dhe në bazë të raportit të komisionit konziliar raporti nuk kishte karakter emergjent, e as pacienti nuk ishte në gjendje kritike për t'ia mundësuar që para përfundimit të procedurës administrative, nepërmjet lëshimit të fletë-garancionit, mbulimin e plotë ose të pjesërishtëm të shpenzimeve të trajtimit në mënyrë retroaktive, por jo më gjatë se 72 orë. Tani, pas vdekjes së pacjentit, nuk ekziston baza ligjore për kompenzim, para se të përfundojë procedura administrative sipas nenit 7.3 të Udhëzimit Administrativ.

Si më sipër, Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e paditësit janë të pabazuara ngase aktgjykimi i shkallës së dytë përmbanë arsye të mjaftueshme dhe se janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, se edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga të lartcekurat, e në zbatim të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos sinë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

ARJ.UZVP.nr.56/2017, më datë 02.11.2017

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi